




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK. Nr. 240/2019
Datë: 12 dhjetor 2019

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 pika 1.1, 1.12, 1.16 dhe 1.25 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e 227- të, të mbajtur me datë 12 dhjetor 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Të gjitha Gjykatat e Republikës së Kosovës të zbatojnë metodën e shqyrtimit të hershëm të lëndëve të reja dhe shqyrtimi i zgjeruar të lëndëve të vjetra, nga vet personeli i gjykatave.
- II. Obligohen Gjykatat që çdo tre (3) muaj të raportojnë në KGJK, lidhur me progresin e arritur nga aplikimi i këtyre metodave.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 12 dhjetor 2019.

A r s y e t i m

Programi i USAID për Fuqizimin e Sektorit të Drejtësisë (JSSP), ka paraqitur Koncept dokumentin e datës 25 mars 2019, duke rekomanduar zbatimin e metodës së shqyrtimit të hershëm të lëndëve të reja dhe shqyrtimit të zgjeruar të lëndëve të vjetra - në të gjitha Gjykatat e Republikës së Kosovës, nga vet personeli i gjykatave.

Pas caktimit të personelit nga ana e gjykatës, zyrtaret e JSSP-së do t'i trajnojnë dhe bartin praktikatat e mira tek gjykata, duke filluar nga Janari 2020 deri në fund të Marsit 2020. Në pjesën e mbetur të programit, JSSP do t'i monitorojë dhe krahasojë arritjet në zbatimin e shqyrtimit të hershëm të lëndëve.

Fillimisht Komisioni për Administrimin e Gjykatave (KAGJ), ka shqyrtuar këtë rekomandim të USAID-it (JSSP) dhe duke marrë parasysh suksesin e arritur nga ky proces në gjykata, vlerësoi se këto metoda ngritin efikasitetin dhe efektivitetin e gjykatave në kryerjen e lëndëve, kështu ka rekomanduar që KGJK, të marrë vendim për t'i Udhëzuar Gjykatat për zbatimin e këtyre metodave (*shqyrtimi i hershëm i lëndëve të reja dhe shqyrtimi i zgjeruar i lëndëve të vjetra*) - nga vet personeli i gjykatave, si dhe çdo tre (3) muaj të raportojnë në KGJK lidhur me progresin e arritur nga aplikimi i tyre.

KGJK, në takim të mbajtur me datë 12 dhjetor 2019, në bazë të Rekomandimit të Komisioni për Administrimin e Gjykatave (KAGJ), si dhe me qëllim të nxjerrjes së politikave për administrimin më të mirë të gjykatave dhe përmirësimin e menaxhimit të rrjedhës së lëndëve nëpër gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Skender ÇOÇAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Gjykatave të Republikës së Kosovës;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe
- Arkivit.